




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



"NEWS TV" SH.P.K..
Nr. i biznesit 70636719
Pronar – Servete Bytyqi
OSHMA NEWS TV
Rr/ R.Luci, nr. 13

"TOP MEDIA" SH.P.K..
Nr. i biznesit 70636719
Pronar: Metë BYTYQI
Rr/Tring Ismajli p.n.

Ref: 1503/216/LIC/ni

VENDIM

për refuzimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë së Ofruesit të Shërbimeve Mediale
Audiovizuale (OSHMA) News TV – me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. News TV është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale , i cili është i licencuar për transmetimin e programit vetëm përmes operatorit të shpërndarjes. News TV është pajisur me licencë të KPM-së për Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale, me datën 18 shkurt 2009.
3. Më datën 19 prill 2016, pronarja e News TV znj. Servete Bytyqi, ka parashtruar një kërkesë për ndryshimin e pronësisë duke e kaluar nga "News TV" Sh.p.k. tek "Top Media" Sh.p.k. me pronarë z. Metë Bytyqi.
4. Më datën 26 prill 2016, Departamenti i Licencimit, përmes e-maili e ka njoftuar palën për mungesën e dokumentacioneve në kërkesën e saj dhe njëherit e ka udhëzuar atë që ta plotësoj kërkesën, në të kundërtën nuk do të mund të procedoj më tutje në shqyrtimin e sajë.
5. Më datën 25 maj 2017, KPM, i ka dërguar shkresë News TV me anë të cilës ka kërkuar që brenda 7 ditëve ta plotësoj kërkesën e sajë në mënyrë që të procedohet tutje për shqyrtim, mirpo, KPM nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Arsyetimi

6. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
7. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
8. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
9. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t'i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t'iu dhënë një licencë.”*
10. Komisioni vlerëson se kërkesa nuk është e kompletuar, për faktin se mungon vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) lidhur me obligimet tatimore të përcaktuara me legjislacionin e ATK-së, si dhe nuk ka paguar tarifën administrative prej 100 eurove, për ndryshime në licencë, siç parashihet me nenin 14 të Rregullores 2017/03.
11. Gjithashtu, News TV nuk ka të kryera obligimet ndaj tarifës vjetore të licencës së KPM-së për vitin 2016.
12. Komisioni vlerëson se, edhe pas njoftimit të palës për mungesat në kërkesën e saj dhe udhëzimit që të dorëzojë dokumentet të cilat mungojnë, ajo nuk ka arritur asnjëherë që ta kompletojë kërkesën.
13. Komisioni konsideron se, kërkesa e parashtruar për ndryshimin e pronësisë së News TV nuk është e kompletuar në pajtim me Rregulorën për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2107/02), Rregullorën për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM – 2017/03) dhe si e tillë nuk i plotëson kushtet për miratim.

Vendim

14. Në takimin e mbajtur më datën 1 gusht 2017, Komisioni merr vendim që, në mungesë të kompletimit të materialeve sipas procedurave dhe akteve nënligjore të KPM-së, të refuzojë kërkesën për ndryshim të pronësisë së News TV.
15. Vendimi për refuzim, nuk e ndalon palën që të parashtrojë kërkesë të re për të njëjtën çështje.

E drejta për Ankesë

16. Në bazë të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligji nr. 04/L-44), palës i njihet e drejta e ushtrimit të ankesës ndaj këtij vendimi.
17. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa

bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

18. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

19. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



02.08.2017

datë